

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21,22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr.350/03-264767/21 dt. 07.12.2021, të aplikueses Rifadie Gashi, Mramor, Prishtinë, për rishqyrtimin e kërkesës “Kërkesë për Kushte Ndërtimore” 05 Nr.350/02-236161/21 dt. 03.11.2021, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës bujqësore/ fermë për pula, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 27.01.2022, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE**

**I. I CAKTOHEN** kushtet ndërtimore aplikueses Rifadie Gashi, Mramor, Prishtinë, sipas kërkesës 05 Nr.350/03-264767/21 dt. 07.12.2021, për rishqyrtimin e kërkesës “Kërkesë për Kushte Ndërtimore” 05 Nr.350/02-236161/21 dt. 03.11.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e ndërtesës bujqësore / fermë për pula, me etazhitet P+0, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1790-0, ZK Dragoc ( sipas dëshmisë së pronësisë është në pronësi të N.T.P. Tempo Trans).

**II. Lokacioni / parcela kadastrale të lartcekur**, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, jashtë zonës së shënuar ndërtimore të këtij fshati, si në pjesën grafike.

Për parametrat, kriteret urbane dhe kushtet e ndërtimit sipas PZHK-së, kërkuesi është informuar përmes “Informim nga Plani Zhvillimor Komunal”, me referencë 04-350/01-211656/21 dt. 05.10.2021, të lëshuar me dt. 08.10.2021, lëshuar përmes Qendrës për shërbim me qytetarë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

**III. Gjendja Ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar**, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
  - nr. 1790-0, ZK Dragoc, me  $S=12762m^2$ , me pronar N.T.P. “Tempo Trans”,  
“Tokë Bujqësore: Kullosë e Klasës 4”, “Tokë Bujqësore: Arë e Klasës”, “Tokë Ndërtimore”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1790-0, ZK Dragoc, ka një objekt ekzistues.
- Terreni ka pjerrtësi nga drejtimi i lindje-perëndim, me disnivel  $\sim 11m'$ ;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale të lartcekur, bëhet përmes parcelës kadastrale nr. 1758-0, ZK Dragoc, e cila është me destinim “Infrastrukturë-rrugë e pakategorizuar”.
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale në fjalë, nuk ka objekte të ndërtuara;

Zhvillimor Komunal, në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të pjesës së parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit – “situacioni i gjerë”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Distanca e vijës ndërtimore nga vija rregulluese duhet të jetë 3-5 metra;
- Parcela kadastrale e trajtuar me këto kushte ndërtimore, për realizimin e ndërtesës bujqësore / fermë për pula, e trajtuar brenda vijës rregulluese, është
  - Nr. 1790-0, ZK Dragoc, me  $S=12762\text{m}^2$ ;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, të jetë për “ndërtesë bujqësore / fermë për pula (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10424-0 ZK Prishtinë, planifikohet ndërtimi i ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projektit konceptual, si në vijim:
  - $S=149.24\text{ m}^2/149.24\text{ m}^2$  mbi tokë dhe  $0.00\text{ m}^2$  nën tokë /
  - Etazhitet: P+0
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas Planit Zhvillimor Komunal, është P+1, kurse i propozuar dhe i miratuar është P+0;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore-brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suteranit, sipas Planit Zhvillimor Komunal, është max.30%;  
Ndërtesë bujqësore / fermë për pula:  
 $S=12762 \times 0.3=3828.60\text{m}^2$  / lejuar sipas PZHK-së /,  
 $S=149.24\text{m}^2$ ; / sipas projekt propozimit /.
- Sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës (ISGJ), duhet të jetë së paku 40% sipas Vendimit 01 Nr.031-185481 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës;  
Ndërtesë bujqësore / fermë për pula:  
 $S=12762 \times 0.4=5104.80\text{m}^2$  / lejuar sipas vendimit/  
 $S=6231.92\text{m}^2$ ; / sipas projekt propozimit /.
- Bazuar në kriteret e PZHK-së, distanca në mes të ndërtesave individuale për banim në fshatra është prej 5-10 metra, varësisht prej numrit të etazheve. Distanca e ndërtesës individuale për banim nga ndërtesat ekonomike (stallat, kotecet etj) apo ndërtesat ndihmëse (fushore depozitë e plehrave etj) duhet të jetë minimum 25-30 metra;
- Elementet ndërtimore të ndërtesës (konzollat, strehët e hyrjeve me dhe pa shtylla etj) në nivel të katit mund të kalojnë vijën ndërtimore, duke llogaritur sipas gabaritit bazë të ndërtesës, gjegjësisht vijën ndërtimore , më së shumti 1.20 metra;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale të lartëcekur, bëhet përmes parcelës kadastrale nr. 1758-0, ZK Dragoc, e cila është me destinim “Infrastrukturë-rrugë e pakategorizuar”.
- Vend parkingjet të sigurohen sipas normave teknike të planifikimit hapësinor, gjegjësisht 4 vend parkingje për çdo  $100\text{m}^2$  ndërtim. Parkimi i jashtëm të planifikohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 40% për gjelbërim, sipas Vendimit 01 Nr.031-185481 dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;

- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

**V. Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale (e skanuar);
- Kushtet Ndërtimore (këtë Vendim të skanuar);
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohortorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

**VI. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme.

**VII. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore ne tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) formë elektronike;
  - Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
  - Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

**IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.**

**X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.**

## A r s y e t i m

Aplikuesia Rifadie Gashi, Mramor, Prishtinë, (qiramarrëse), me kërkesën 05 Nr.350/03-264767/21 dt. 07.12.2021, i është drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, për rishqyrtimin e kërkesës “Kërkesë për Kushte Ndërtimore” 05 Nr.350/02-236161/21 dt. 03.11.2021, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës bujqësore / fermë për pula, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesën 05 Nr.350/03-264767/21 dt. 07.12.2021, për rishqyrtimin e kërkesës “Kërkesë për Kushte Ndërtimore” 05 Nr.350/02-236161/21 dt. 03.11.2021, dhe gjatë fazës së trajtimit është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni:

- *Certifikatën e njësisë kadastrale nr. P-71914030-01078-0, P-71914030-01081-0, P-71914030-01082-0, dhe P-71914030-01083-0, ZK Dragoc, dhe kopja e planit të njësisë kadastrale nr. 1078-0, 1081-0, 1082-0 dhe 1083-0, ZK Dragoc;*
- *Certifikatën e njësisë kadastrale nr. P-71914030-01790-0, dhe kopja e planit të njësisë kadastrale nr. 1790-0, ZK Dragoc;*
- *Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Rifadije Gashi, nr. 264157/21 dt. 06.12.2021;*
- *Kopje e dokumentit të identifikimit të Ardian Gashi dhe Rifadie Gashi;*
- *Shkresa “Vërtetim Tatimor” për Ardian Gashi, lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, dt. 06.12.2021, nr. 1000844717;*
- *Shkresa “Vërtetim Tatimor” për Ardian Gashi, lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, dt. 06.12.2021, nr. 1000844715;*

- Shkresën "Informim nga Plani Zhvillimor Komunal", me referencë 04-350/01-211656/21 dt. 05.10.2021, të lëshuar me dt. 08.10.2021, përmes Qendrës për shërbim me qytetarë, nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm - Prishtinë;
- Kopje e ekstraktit të aktit noterial "Kontratë qiraje", në të cilën pronari i parcelave kadastrale nr. 1081-0, 1082-0 dhe 1083-0, ZK Dragoc, N.T.P. Tempo Trans, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ardian I. Gashi, si qiradhënës, dhënë qiramarrësit Rifadie Gashi, me qira parcelat e lartëcekura për Fermë të pulave, përpiluar te noteri Faton R. Muslija, në Prishtinë, LRP.Nr. 1536/2020, Ref. Nr. 324-2020, dt. 25.06.2020;
- Ekstrakt të aktit noterial "Kontratë për qira të patundshmërisë", në të cilën pronari i parcelave kadastrale nr. 1790-0, ZK Dragoc, N.T.P. Tempo Trans, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ardian I. Gashi, si qiradhënës, dhënë qiramarrësit Rifadie Gashi, me qira parcelën e lartëcekur për nevoja afariste të qiramarrësit, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj, në Prishtinë, LRP.Nr. 18457/2021, Ref. Nr. 5127/2021, dt. 06.12.2021;
- Kopje e certifikatës së biznesit me emër tregtar N.T.P. "Tempo Trans", me nr. unik identifikues 810945082, me seli në Prishtinë, me pronar Ardian Gashi;
- Manuali gjeodezik me koordinatat për pozicionimin e objektit, për parcelat kadastrale nr. 1081-0, 1082-0, 1080-0, 1078-0 dhe 1079-0 ZK Dragoc, i punuar nga gjeodeti i licencuar Afrim Bytyqi, me nr. të licensës 1, dt. e rilevimit 25.10.2021;
- "Projekti zbatues", të punuar nga kompania projektuese "Kompania Prishtina" shpk, me seli në Prishtinë, nr. i biznesit 810510190;

Drejtoria e Urbanizimit, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës 05 Nr.350/03-264767/21 dt. 07.12.2021, për rishqyrtimin e kërkesës "Kërkesë për Kushte Ndërtimore" 05 Nr.350/02-236161/21 dt. 03.11.2021, dokumentacionit dhe provave të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për hapësirën ku gjendet lokacioni-PZHk-në, rregullativën ligjore nga lëmi i ndërtimit, planifikimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe konsultimin e projekt propozimit – Projektit konceptual të ndërtesës me Planin e situacionit të prezantuar, në mënyrë kronologjike ka konstatuar se:

Kjo drejtori pas pranimit të kërkesës, shqyrtimit të saj me dokumentacionin e prezantuar, dhe konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për ndërtim Nr.04/L -110 dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr.06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosë shkresën "Njoftim publik" për njoftimin dhe mundësin e dhënien së komenteve të pronarëve dhe poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m' nga parcela ku synohet të ndërtohet, i cili njoftim ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë, nga data 18.01.2022 deri me datë 22.01.2022, gjatë së cilës periudhë nuk kanë arritur komente në E-mail adresat e vendosura në njoftimin publik;

Aplikuesia Rifadie Gashi, Mramor, Prishtinë, sipas kërkesës 05 Nr.350/03-264767/21 dt. 07.12.2021, i është drejtuar Drejtorisë së Urbanizimit, për rishqyrtimin e kërkesës "Kërkesë për Kushte Ndërtimore" 05 Nr.350/02-236161/21 dt. 03.11.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e ndërtesës bujqësore / fermë për pula, me etazhitet P+0, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1790-0, ZK Dragoc, e cila parcelë sipas dëshmisë së pronësisë është në pronësi të N.T.P. Tempo Trans, ku i njëjti e ka jap në shfrytëzim/me qira, Rifadie Gashit, bazuar në Ekstraktin e aktit noterial "Kontratë për qira të patundshmërisë", në të cilën pronari i parcelave kadastrale nr. 1790-0, ZK Dragoc, N.T.P. Tempo Trans, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ardian I. Gashi, si qiradhënës, dhënë qiramarrësit Rifadie Gashi, me qira parcelën e lartëcekur për nevoja afariste të qiramarrësit, përpiluar te noteri Sefadin Blakaj, në Prishtinë, LRP.Nr. 18457/2021, Ref. Nr. 5127/2021, dt. 06.12.2021.

Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale të lartëcekur, bëhet përmes parcelës kadastrale nr. 1758-0, ZK Dragoc, e cila është me destinim "Infrastrukturë-rrugë e pakategorizuar".

Andaj si konkludim përfundimtar, pas konstatimeve të lartë shënuara, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni (Planit Zhvillimor Komunal), rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim

përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimin për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, është prezantuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe projekt propozimi, Projekti konceptual me “situacioni i gjerë”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret e Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacionit “Situacioni i gjerë” me vijën ndërtimore dhe vijën rregullues.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-Departamenti Ligjor i MMPH-së.

**Ky Vendim është përpiluar në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkuesit, në dosje të lëndës 05 Nr.350/03-264767/21 dt. 07.12.2021, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me Qytetarë.


**Përmes postës elektronike i dërgohet:** Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

## DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 350/03-264767/21 DT. 27.01.2022

Zyrtare,

Ermira Muçiqi



u.d.Udhëheqëse e Sektorit

Mimoza Berisha Prestreshi

